

DITARI MUJOR

JANAR 2025



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN

THIRRJA E EKSELENTËVE, 105 TË RINJ PËRZGJEDHIN POZICIONET E TYRE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE

Departamenti i Administratës Publike ka përfunduar me sukses procesin e përzgjedhjes së 105 të rinjve dhe të reja të cilët do të fillojnë së shpejti punë në administratën shtetërore. Këta të rinj, të cilët kanë përfunduar studimet bachelor dhe master me rezultate të larta, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë vendit, u përzgjedhën nëpërmjet thirrjes së fundit të punësimit të ekselehtëve në administratën shtetërore. Procesi i përzgjedhjes u zhvillua në datat 15-17 janar 2025, ku 372 ekselehtë të kualifikuar, të renditur sipas pikëve të grumbulluara, patën mundësinë të zgjedhin nga 153 pozicionet e ofruara në 80 institucione shtetërore në 22 qytete të vendit, duke mbuluar 31 profile të ndryshme. Të rinjtë e punësuar falë kësaj thirrjeje do të përfitojnë një përvojë pune 1-vjeçare. Pas një viti, ata do të kenë mundësinë të aplikojnë për pozicionet e tyre aktuale ose për pozicione të tjera, duke përmbushur kriterin e eksperiencës që kërkohet në fazën e rekrutimit me konkurs.



MINISTRJA PIRDENI TAKON AMBASADORIN SUEDEZ, Z. NIKLAS STRÖM

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni u takua me Ambasadorin e Suedisë në Shqipëri, Z. Niklas Ström. Takimi u fokusua në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në fushat e reformës së administratës publike, luftës kundër korrupsionit dhe përmirësimit të shërbimeve publike. Takimi u përfundua me një shkëmbim mendimesh për hapat e ardhshëm të bashkëpunimit dhe zgjerimin e projekteve që promovojnë transparencën dhe etikën në sektorin publik.

PUBLIKOHET MANUALI PRAKTIK PËR “ETIKËN NË ADMINISTRATËN PUBLIKE”

Në muajin janar 2025, u publikua manuali praktik për “Etikën në Administratën Publike”, i cili shpjegon dhe trajton hollësisht rregullat e etikës. Hartimi dhe botimi i këtij manuali është një hap i rëndësishëm në drejtim të sigurimit të transparencës së administratës publike ndaj qytetarëve. Përmes këtij manuali, punonjësit e administratës publike do të kenë një kuadër të qartë rregullash që mund t'u referohen lidhur me sjelljen dhe angazhimin e tyre profesional, duke normuar kështu veprimtarinë dhe etikën e punës së tyre. Gjithashtu, këto rregulla janë një instrument i vlefshëm edhe për qytetarët për të monitoruar aktivitetin e administratës publike. Për të siguruar përdorimin sa më efektiv të tij, ky manual shoqërohet me raste dhe shembuj konkretë të aplikimit të rregullave të etikës. Në vijimësi, ASPA (Shkolla Shqiptare e Administratës Publike) do të trajtojë stafin e burimeve njerëzore në institucionet publike, me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe njohurive për zbatimin e këtyre rregullave në praktikë.



Ministër i Shtetit për Administratën
Publike dhe Antikorrupsionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni